

## **Ndal Dhunës Seksuale në Koflikte**

**Samiti Global Londër 2014**

### **DEKLARATË PËR VEPRIM**

Jemi mbledhur bashkë në Samitin Global në Londër më 10 deri 13 Qershor sepse jemi të vendosur që ti japim fund përdorimit të përdhunimeve dhe dhunës seksuale në konflikte në mbarë botën.

Gjatë jetës, kemi parë shumë njerëz, familje dhe komunitete të shkatërruara nga këto krime. Për një kohë shumë të gjatë përgjegjësit e këtyre krimeve nuk kanë dhënë llogari. Ne ndajmë së bashku përkushtimin dhe vendosmërinë se kjo duhet të ndryshojë. Ne jemi të qartë se parandalimi i dhunës seksuale në konflikte është kyçe për paqen, sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Së bashku, ne deklarojmë se përdhunimi dhe dhuna seksuale nuk janë pasojë e paevitueshme e luftës apo një krim më i lehtë. Nga dita e sotme e në vazhdim, turpi për këto krime duhet të qëndrojë mbi ata të cilët kryejnë këto vepra, e jo mbi viktimat e tyre.

Ne i nderojmë këta njerëz, posaqërisht të mbijetuarit të cilët janë bërë avokues të fuqishëm, të cilët kanë punuar parreshtur për shumë vite me rradhë, për të fituar vëmendjen tonë për këtë çështje. Ne qëndrojmë krah për krah me të gjitha viktimat dhe të gjithë të prekurit nga dhuna seksuale në konflikte. Ne ju sigurojmë atyre dhe komunitetet me të cilat punojnë se ne jemi të vendosur që t'ju ofrojmë mbështetjen që ata kanë nevojë dhe që t'ju kërkojmë përgjegjësi të gjithë atyre që kanë kryer këto krime apo janë në ndonjë mënyrë tjetër përgjegjës për këto krime, me të gjitha mjetet që ne kemi në dispozicion.

Ne jemi përkushtimin tonë të punojmë së bashku, në frymën e një vendosmërie të palëkundur, që t'i përgjigjemi urgjencës së kësaj çështjeje. Secili njeri ka përgjegjësi morale që ta ngrej zërin- në nivel lokal, kombëtar dhe global- që të kërkojë ndryshim në mënyrën se si bota i percepton dhe i përgjigjet këtyre krimeve. Ne jua kemi borxh gjeneratave të ardhshme që ti japim fund njërës prej padrejtësive më të mëdha të kohës sonë.